

## EKSTRAKT NGA INTERVISTA

*[Intervista e gjatë e historisë gojore me narratoren u realizua më 16 maj, 2021 në Prishtinë. Me kërkesen e narratores për anonimitet, ne kemi fshehur identitetin.]*

**Narratorja:** Atëherë që dolën në Gjermani, që ke qajo vala e azilantav, patëm dalë bashkë na me burrë. E kom pasë edhe djalin dy vjet i ka bo atëherë domethonë. Pata dalë.

**Intervistuesja:** Qysh keni dalë?

**Narratorja:** Kena dalën, niherë këtu kena pasë hyp në autobus, me autobus jena shku në Sërbi, prej Sërbisë ni, ni familjar dikush e ka gjetë ni njeri, ka thonë, “Ju merr ky edhe keni me hypën domethonë në Novi Sad edhe kanë me ju çu deri në Austri kanë me ju qitën, pa problem”. Na hypëm në atë kerr edhe na lanë në kufi me Sërbinë, Sërbi-Hungari. Tha, “Veç kalone qeto, dilni te asfalti” tha, “une dal ju marr anej”. Na e kalunëm udhën, dolëm anej, e kalunëm domethonë kufinin pa problem. Prit, mo ai hiç, domethonë u zhduk njeri (qesh), na ra me ecun, s’po di me thonë kur kena mrrri atje në ora 11:00 deri në 05:00 mramje.

Veç kena ecë udhës, veç ecshum, ecshum, djalin e kom pasë shumë të vogël, ni vjet e gjysë, domethonë dy vjet m’i ka bo atje. Edhe kajke nonstop thojke, “Po du m’u kthy te shpia”. E dike, na shkojshum drejt anej, ai u kthejke, “Jo” thojke, “Po du m’u kthy te shpia, te shpia”. Jom konë me burrë, me kunat edhe me dy shokë të burrit. Ata më kanë nimu shumë, se e majshin shumë në krah, u munojshin me mashtru. Unë e kom pasë në gji në atë kohë edhe nonstop kur lypke me pi u dufke qishtu *hopa* {onomatope} me çu edhe t’u ecë tu i dhonë gji (qesh). Kaniherë u ulshum, pushojshim, po ma shumë kena ecë dej sa na nxunën policia e Hungarisë, na tubunë krejtve.

Tani na murrën veç familjarë çka janë domethonë me fëmijë, hypëm me ni, na hypën me ni kombi të burgosunëve edhe na çunën me nifarë garazhe ish konë. A kunati me shokë të burrit metën aty se thanën, “Ju marrim ma vonë”. Na çunën me ni garazhë ish konë thuj se krejt ujë aty, na shtinën qaty. Dej sa na murrën do të dhana, nuk e di çka bojshin ata. I kanë pru dy autobusa, tani me autobusa na kanë marrë edhe na kanë çu me nifarë burgu, emrin s’ja di atij venit ish konë si burg. Aty kur jena hi

jom konë qaq e lodhne, e dërrmume, si jena hi kom flejt mo s'kom ditë kurgjo dej sa u ardhë polici në mëngjes, na ka kërshit në derë.

Nuk na kanë majt shumë, na kanë dhonë edhe bukë e ujë e krejt senet, a din malltretim s'kena pasë kurgjo. Edhe i kena marrë domethonë ato, janë ardhë na kanë thirrë edhe janë ardhë na kanë marrë të dhanat komplet, me qit gishtin ato çka shkojnë edhe na kanë liru domethonë. Po na dojshim me u bo bashkë edhe me kunatin edhe me ata shokët. Ni natë anej e kena marrë ni hotel, ish konë si motel kështu diçka. Edhe jena hi kena nejt aty ni natë dej sa jena bo bashkë me ta. Kur jena bo bashkë me ta tani qai njeri që ka pasë me ardhë me na marrë, ai veç na rrejti, nuk ka ardhë me na marr hiç.

Kena marrë taksi, edhe bile njoni taksist që u konë që na ka pasë çu ish konë polic ai, po i ka konvenu nashta çmimi, se në Ballkan në përgjithësi korrupcioni (qesh) është numër ni. Edhe na ka marrëm na ka çu deri në Budapest. Në Budapest tanaj kemi nejtun në hotel, u ardhë... qai shoku i burrit e gjeti dikon të njofshëm, u ardhë na ka marrë me kerr edhe na kanë çu deri në Austri. Më ka marrë mu me fëmi edhe atë djalin. Se e çoi tezja atij djalit me e marrë edhe na kanë lonë në Austri, në stacion të trenav, na kanë nxjerrë mu edhe burrit, tha, "Hajde me mu" tha, "të ja u nxerri une biletën se mos po ju vërejnjë juve". U konë atë ditë shumë t'u ra borë, tepër u konë.

Domethonë, kena pasë mu nisë për Gjermani në ora 12:00 ditës, nuk jena nisë deri në ora 2:00 të natës, kena nejt në stacion se u bllokun udhët krejt komplet. Në ora 2:00 të natës jena hyp në tren kena mrri diku ka ora 5:00 a 6:00 në Gjermani. Atje kur shkunëm s'dishëm as ka me ja majtën, se s'dishim as gjuhë, as vend, as kurgjo. Edhe metum qaty, jena hi me ni kafe, i thojsha burrit, "Hajde hina veç të nxehum pak, a bojna diçka" se shumë u konë ftohtë. Edhe jena hi qaty kena nejtën, domethonë nja ni orë. Jena zatet me ni familje shqiptare që ishin ardhë qishtu si na refugjatë. Ish konë burri, gruja, e i kanë pasë katër fëmijë.

Amo edhe ai burri vet i kish thonë, "Hajde ti se si të vish në Gjermani veç kallxom ku je une vi të marr". Edhe ai ish nisë me shpresë se ka me marr vëllai vet, në fakt e thirrke në telefon, nuk ja çilke telefonin, veç i shkrujke, "Shko qetu" a din, me emra, atje. Po ai nuk dike, as burri, as gruja, as fëmitë, ishin konë shumë të vogël, nuk e dishin ata as anglishtën, as gjermanishtën, asni gjuhë hiç. Ku me shku ai, s'e dike as ku nxirret bileta, as çka bohet, veç met midis udhe njeri. Edhe i thanum... se na anglishtën, a din, e dishëm pak a shumë edhe i tha burri, "Hajde me mu". Tani e zatetum ni shiptarë me letra atje, na blejti do bileta e tha, "Shkoni në Shtutgard", na jena konë në Mynhen më doket qaty. Edhe na i ka nxerrë biletat.

Tash u dufke m'i ndrru shumë shpesh trenat aty. Edhe burri jem i kuptojke pak a shumë. Edhe jena shku dej atje, aty e kena lonë ato, na u lajmërum azil domethonë në polici, ai nuk e di çka ka bo, ka u shku, se s'dike as vet, domethonë e kish rrejt vëllau i vet. Aty s'kena nejt shumë, nja katër mujë në Gjermani. Kena nejt, ni mujë kena nejt në kamp, tre mujë na kanë pasë qit në banesë, domethonë e

kom pasë banesën veç me burrë e me djalë. Dhoma, salloni, kuzhina, u konë mirë, domethonë me na mungu s'na ka mungu kurgjo hiç, janë kujdes shumë mirë për neve.

Qat venin ku jena konë na u konë Osna... Osnabruk, jo njo tjetër, qysh u konë, po më del prej mendjes (qesh) emri tina. Se tha... jonë konë do plaka aty e tha asi, "Edhe lufta në Kosovë kur u konë" tha, "te na" tha, "nuk ka pasë refugjatë shqiptarë. Domethonë, ju jeni të partit që ju kanë pru". Jena konë veç na edhe ni çikë e ni djalë, jonë konë çift ata. E shumë na kanë nejt gati, se s'kishin pasë kurrë refugjatë prej asni ane. Edhe tani na erdh [ftesa], shkunëm në intervistë, po tani na ka ardhë negativi edhe e kena nënshkru meniherë, u kthynëm. Se thojshin, "P'i marrin me zor nëpër shpija e sene". Burri tha, "Masi e kom djalin je edhe ti nuk po du as me ikë as kurgjo" na ka ardhun edhe jena kthy.